

## **AKT THEMELIMI**

I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "DentPlus" shpk

Ne Tiranë, sot me datë 18 Qershor 2024, në cilësinë e "ortakut themelues":

Z. Fjodor Ashiku, i dtl. 21.02.1965, lindur në Tiranë, Republika e Shqipërisë, dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtes mjet identifikimi me numër G50221033G, në cilësinë e "ortakut themelues", me vullnet të lirë, të plote e të sigurtë, hartoi këtë akt themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "DentPlus" shpk mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" të ndryshuar me ligjin 129/2014, në ligjin 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor.

### **KREU I**

#### **Neni 1 - Krijimi**

Shoqëria "DentPlus" shpk, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria"). Emri tregtar i shoqërisë "DentPlus" shpk.

#### **Neni 2 - Personaliteti Juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqëria "DentPlus" shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortakët i shoqërisë, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e

pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

#### **Neni 3 Selia**

Shoqëria e ka selinë kryesore në Tiranë, në adresën Rruga. Frosina Plaku, Pallati Leo,



Shkalla 4 Apartamenti. 4036, Tiranë. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e tij, të hapë zyra perfaqesie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të ortakut të shoqërisë. Neni 4 - Objekti i Veprimtarisë Import eksport, tregti me shumicë dhe pakicë të produkteve të shëndetit oral, paste dhembesh, furçe dhembesh.

#### **Neni 5 - Kohezgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

## **KREU II - KAPITALI**

#### **Neni 6 - Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (Njëqind mijë) Leke. Ky kapital është nënshkruar dhe do të shlyhet sapo të hapen llogaritë bankare të shoqërisë, teresisht në të holla nga ortaku i shoqërisë:

Z. Fjodor Ashiku është zoterues i 1 kuote me vlerë 100,000 Leke, e Cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### **Neni 7 - Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emerimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogelohet me vendim të Asamblesë së Ortakut në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

#### **Neni 8 - Transferimi i Kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) Shitblerjes; c) Trashegimise; q) Dhurimit; d) Cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga gosti i kalimit të kuotave, deri në qastin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendren Kombëtare të



Regjistrimit. Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### KREU III - ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### **Neni 9 - Organi Vendimmarres**

Asambleja e ortakut eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e ortakut eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton qdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB Per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e ortakut vendos Per qeshtje si: a) Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;

b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve; c) Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar; q) Percaktimin e shperblimeve; d) Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise; e) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; f) Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.

Te gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veganti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per: a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise; b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; c) Investime; q) Vendimet Per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, perveq rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni Per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni Per te.



### **Neni 10 - Administrimi**

Administratori i shoqerise eshte Z. Fjodor Ashiku. Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit Per nje afat prej 5 vjetesh nga data 18.06.2024 deri me 23.05.2029. Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te asamblese se ortakut te shoqerise. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.


### **Neni 11 -Kompetencat**

Administratori ka te drejte e detyrohet te: a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e ortakut; b) Perfaqesoje shoqerine tregtare; c) Kujdeset Per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise; q) Pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet Per shperndarjen e fitimeve, i paraqet keto dokumente perpara asamblese se ortakut Per miratim; d) Krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur Per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise; dh) Kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sig parashikohet ne ligjin Per Qendren Kombetare te Regjistrimit; e) Raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaqme me rendesi te veqante Per veprimtarine e shoqerise tregtare.

Administratori eshte i detyruar te therrase mbledhjen e asamblese Se ortakut edhe ne rastet kur: sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te tij, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 Per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfaqeson shoqerine perpara te gjitha personave fizike ejuridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shtetere shqiptare apo te huaja, bankave te te gjitha niveleve, zyrave te

tatimtaksave, autoriteteve doganore, perfshi ketu edhe autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleve. Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e tij.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratoreve e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.



## **Neni 12 - Përgjegjësitë**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja e ortakut që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis; b) Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita; c) Të vlerësojë me përgjegjësi qështjet, për të cilat merret vendim; C) Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë; d) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrës së tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për cdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe



vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë qdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të vecantë, por pa u kufizuar në tot administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" kryen veprimet e mëposhtme: a) U kthen ortakëve kontributet; b) U paguan ortakëve interesa apo dividendë; c) U shpërndan aktivet shoqërisë; ç) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueuse për të shlyer detyrimet; d) Jep kredi.

### **Neni 13 - Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### **Neni 14 - Bilanci i Shoqërise dhe Dividentet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, mbledhja e Asamblesë së Ortakut miraton bilancin e paraqitur nga administratori. Mbledhja e Asamblesë së Ortakut vendos rreth shpërndarjes së dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

### **Neni 15 - Baza Ligjore**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 16 - Dispozita Përfundimtare**

Ky Akt themelimi i shoqërisë "DentPlus" shpk, u redaktua me vullnetin të lirë e të plotë të "ortakut themelues", në 2 ekzemplare me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe.

**ORTAKU DHE THEMELUES I SHOQËRISE**

Fjodor Ashiku

A handwritten signature in black ink, consisting of several overlapping, fluid strokes that form a stylized, somewhat abstract shape. The signature is positioned below the name 'Fjodor Ashiku'.